

Presionet Globale Inflacioniste:

Ndikimi në Kosovë dhe rajon

KASTRIOT DAUTAJ
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Banka, Financa & Kontabilitet
Maj 2022

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij artikulli të shkurtër shkencor është të vlerësojë rrethanat e reja të krijuara nga zhvillimet ekonomike aktuale si rezultat i pandemisë Covid-19 dhe situatën e re të krijuar pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia. Në mënyrë të veçantë, do të fokusohem në rritjen e çmimeve – inflacion për shkak të situatës pas pandemisë Covid 19 si rezultat i mospërputhjes mes ofertës dhe kërkesës, çmimeve më të larta të energjisë dhe inflacionit të shkaktuar si rezultat i pushtimit të Ukrainës nga Rusia, dy eksportuesit kryesorë botërorë të mallrave dhe energjisë.

Aktivitetet ekonomike gjatë viteve 2021/2022 kanë ndryshuar për shkak të rrethanave të reja të krijuara. Kriza të ndryshme shëndetësore dhe ekonomike kanë ndikuar ndjeshëm në ekonominë globale dhe një nga shkaqet e tyre është pandemia Covid-19. Pandemia përmbysi çdo aspekt të zinxhirëve global të furnizimit, që nga nevojat e klientëve dhe disponueshmëria e materialit e deri te fuqia punëtore dhe aftësitë digjitale. BPV-ja mesatare globale ka rënë për 2.9 për qind nga 2019 në 2020. Ne ende jemi duke u rimëkëmbur nga kriza ekonomike dhe shëndetësore, por po na përcjellin pasiguri të reja.

Lufta në Ukrainë ka shkaktuar çrregullime të mëdha të furnizimit dhe ka çuar në çmime historikisht më të larta për një numër mallrash. Sanksionet evropiane ndaj Rusisë po ashtu kanë rritur çmimet për produktet themelore si vaji dhe drithërat. Një problem tjetër i ballafaquar ishte rritja e çmimeve të energjisë për shkak të ofertës dhe kërkesës në tregun global të shitjes me shumicë (BBC).

Ndikimi në zinxhirin e furnizimit ndodhi për shkak të kompleksitetit të dukshëm të një zinxhiri tipik global të furnizimit të mallrave të konsumit që përfshin miliona dërgesa dhe mijëra furnizues. Për të adresuar këtë sfidë të re "zotëruesit e zinxhirit të furnizimit" janë duke krijuar zgjidhje të reja nga fillimi deri në fund për të krijuar një zinxhir të ri të furnizimit - një zinxhir që nuk mund të këputet nga ngjarje të tilla të papritura (BBC).

Shkurtesat:

IHÇK - Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

KFG – Kriza Financiare Globale

PRE – Programi i Reformës Ekonomike

IHD - Investimet e Huaja Direkte

NPL - Kreditë jo performuese

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës


BQK – Banka Qendrore e Kosovës

1.0 Hyrje – trendet e fundit në botë

Rritjet e çmimeve ishin veçanërisht të theksuara për mallrat, sepse Rusia dhe Ukraina janë eksportues të mëdhenj, veçanërisht të energjisë, plehrave, drithërave dhe metaleve. Këto zhvillime në çmimet botërore të mallrave për shkak të ndërprerjes në zinxhirin e furnizimit si rezultat i pushtimit të Ukrainës nga Rusia dhe lufta që ende po vazhdon i kanë dhënë hov rritjes së gjerë të çmimeve të mallrave që filloi në mesin e vitit 2020 me një rritje të kërkesës të shkaktuar nga zvogëlimi i shqetësimeve për pandeminë COVID-19. Kërkesa për mallra u rrit sërish me rimëkëmbjen e ekonomisë globale, ndërsa prodhimi i mallrave u rrit më ngadalë, duke qenë i rënduar nga disa vite të investimeve të dobëta në kapacitete të reja prodhuese si dhe për shkak të çrregullimeve të ndryshme të furnizimit. Çmimet e plehrave u rritën për 220 për qind mes prillit 2020 dhe marsit 2022, rritja e tyre më e madhe 23-mujore që nga viti 2008. Çmimet e ushqimeve janë rritur për 84 për qind, që është rritja e tyre më e madhe në një periudhë krahasuese që nga viti 2008. Këto rritje të çmimeve janë duke pasur ndikime të mëdha humanitare dhe ekonomike dhe duke rënduar pasigurinë ushqimore dhe inflacionin në shumë vende (Banka Botërore).

Inflacioni kishte luhajte të mëdha gjatë pandemisë, duke rënë në nivele të ulëta shumëvjeçare pas shpërthimit të pandemisë, para se të ngrihej në nivelet më të ulëta historike me një ritëm të paparashikuar të shpejtë. Kolapsi ekonomik u shënuar me rënie të çmimeve, me ngadalësim të inflacionit në të gjitha vendet e eurozonës dhe zhytje në pjesën negative në 15 nga 19 vendet. Nga korriku deri në dhjetor 2020, çmimet e përgjithshme në eurozonë u tkurrën për 5 muaj radhazi, ngjashëm me periudhën e gjatët të tkurrjes në vitin 2009 pas krizës globale financiare (KGF). Për dallim nga kjo, faza e dytë, duke filluar nga viti 2021, u karakterizua me një inflacion çuditërisht të vrullshëm, që kulmoi me nivelin më të lartë historik prej 5.9% në muajin shkurt 2022. Përmasa dhe shpejtësia e kësaj rritjeje të inflacionit erdhi si befasi, duke tejkaluar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet institucionale dhe ato të tregut gjatë tërë vitit.

Graph 1. Intra-euro area inflation dispersion (% y-o-y)



Source: Eurostat

2.0 Gjendja ekonomike në Kosovë

2.1 Zhvillimet kryesore

Edhe gjatë krizës sociale dhe ekonomike, skenari i saj makroekonomik parashikon që BPV-ja reale të rritet për 7-8% gjatë periudhës së programit, shumë mbi normat e trendit historik, të shkaktuara nga një program ambicioz i investimeve private dhe publike. PRE parasheh që deri në vitin 2023 të ketë një kthim gradual në tavanin e deficitit fiskal të BPV-së prej 2%, siç përcaktohet në kornizën e rregullave fiskale të Kosovës. Në shkurt të vitit 2022, Kosova rriti çmimet e rregulluara të energjisë, duke aplikuar një strukturë tarifore me dy nivele për konsumatorët familjarë, duke i mbajtur çmimet aktuale të energjisë elektrike për amvisëritë që konsumojnë më pak se 800 kWh dhe duke dyfishuar çmimet për ata që konsumojnë më shumë. Tarifat për konsumatorët jofamiljarë, përfshirë sektorin industrial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bizneset dhe klientët me shumicë mbeten të pandryshuara. Qeveria ndau 120 milionë euro për subvencione për energjinë; 30 milionë euro të destinuara për sigurimin e importit të energjisë elektrike, ndërsa pjesa tjetër do të përdoret për stabilizimin e çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët e vegjël, gjegjësisht familjet që harxhojnë deri në 800 kW, dhe pjesërisht për kompensimin e rritjes së çmimeve për konsumatorët më të mëdhenj (më shumë se 800 kW).

2.2 Sektori real

Me ndihmën e diasporës, ekonomia e Kosovës pati një shkallë të lartë të rimëkëmbjes, vlerësimi provizor i rritjes vjetore të BPV-së në vitin 2021 është 10.5%. Eksportet performuan shumë mirë (78.2), ku eksportet e shërbimeve dhe mallrave u rritën për 91% dhe 51%. Mbështetja e mëtejshme për rritjen ekonomike erdhi si rezultat i një rritjeje të fuqishme të investimeve dhe konsumit publik, të cilat u rritën për 10.2% dhe 9.1% përkatësisht. Flukset e mëdha të remitencave dhe transferet e larta sociale kontribuan në një rritje të fuqishme vjetore të konsumit privat (7.6%). Rritja e BPV-së pësoi rënie për shkak të rritjes së shpejtë të importeve të mallrave dhe shërbimeve (32.5%). Në tremujorin e katërt të vitit 2021, BPV-ja u rrit për 6.4% në vit për shkak të konsumit privat dhe eksporteve, të cilat u rritën përkatësisht për 9.4% dhe 33.4% në vit. Konsumi publik u rrit për 4.5% ndërsa investimet ngecën në 0.85%.

2.3 Tregu i punës

Sa i përket tregut të punës, Kosova vazhdon të ketë shkallën më të lartë të papunësisë në rajon, të dhënat më të fundit në dispozicion paraqesin një shkallë të papunësisë prej 25.8% (TM1 2021). Për më tepër, është shqetësues fakti se shkalla e inaktivitetit (njerëzit që janë në moshë pune, por që nuk kërkojnë punë) është rreth 60.5%, që është po ashtu shumë e lartë, madje krahasuar me rajonin është më e larta (ASK). Në anën tjetër, aktiviteti joformal në Kosovë pritet të jetë rreth 25-30% sipas organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore dhe FMN-ja, e po ashtu edhe numri i të punësuarve pa kontrata është i lartë, sidomos në sektorin e ndërtimit. Pra, besoj se kjo është arsyeja pse Kosova ka një shkallë shumë të lartë të pasivitetit. Në përgjithësi, Kosova ka një shkallë të lartë të papunësisë dhe qeveria duhet të hartojë politika për ta trajtuar këtë çështje dhe për të krijuar kushte më të mira për ndërmarrjet e në veçanti për të tërhequr kapitalin e huaj për të investuar në Kosovë dhe për të përdorur potencialin e një fuqie punëtore shumë të re dhe të talentuar.

2.4 Sektori i jashtëm

Prej vitit 2020 deri në 2021 deficitin është rritur për 2.2% (2020 - 7%, 2021 - 9.2%). Shtytësi kryesor i kësaj ishte rritja e madhe e importeve të mallrave (41%), e cila baraspeshoi performancën e mirë të eksportit dhe bëri që deficitin tregtar të mallrave të rritej në 53% të BPV-së. Faktori kryesor që kompensoi deficitin tregtar të mallrave janë remitencat, të cilat u rritën për 20% në vitin 2021 dhe arritën në 15.8% të BPV-së. Remitencat e tjera jozyrtare janë pasqyruar me gabime dhe lëshime më të mëdha (2.5% të BPV-së) në vitin 2021. Flukset neto hyrëse të IHD-ve treguan një performancë të mirë me 3.9% të BPV-së, e cila u mbështet pjesërisht nga ndalimi i shpërndarjes së dividendave. Tre muajt e rezervave zyrtare mbuluan 3 muajt import në TM3 2021. Në periudhën janar - shkurt 2022, falë performancës së mirë të produkteve plastike dhe minerale, eksportet e mallrave u rritën për gjithsej 40%, ndërsa eksportet e metaleve bazë pësuan rënie në krahasim me vitin 2021. Në të njëjtën periudhë, importet u rritën për 42% si pasojë e rritjes së importeve të produkteve minerale, ndërkohë që deficitin i përgjithshëm tregtar të mallrave u rrit për 40%. Gjatë vitit 2021, inflacioni vjetor ka shfaqur trend të rritjes nga 0.6% në tremujorin e parë në 6.4% në tremujorin e katërt. Ky trend në rritje ka ndodhur për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë (Komisioni Evropian).

2.5 Sektori i Financiar

Sektori bankar në pronësi të huaj ishte stabil dhe fitimprurës në vitin 2021, sepse u mbështetën nga rimëkëmbja ekonomike. Në gjysmën e dytë të vitit 2021, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) hoqi gradualisht masat mbështetëse që lidheshin me pandeminë. Ristrukturimi rregullativ me kohë dhe flukset e mëdha nga diaspora i dhanë shtytje rritjes së shpejtë të kreditimit, veçanërisht atij të ekonomive familjare. Rritja e kreditimit bankar u rrit në 11.2% në vitin 2021 nga 7.1% sa ishte një vit më herët. Rritja e depozitave shkoi në 13.8% nga 12.2% në vitin 2020. Treguesit e shëndetit financiar mbetën të kënaqshëm. Në fund të vitit 2021, raporti kredi/depozita dhe raporti i kredive joperformuese (NPL) mbetën në 76.5% dhe 2.1% përkatësisht. Niveli i NPL-ve mbeti i ulët në 2.2% në muajin shkurt dhe NPL-të ekzistuese u mbuluan plotësisht nga provizionet e humbjeve të kredisë (150.3%). Rentabiliteti i bankës është rritur me një rritje mesatare të shkallës së kthimit të kapitalit në 17.6% në vitin 2021 nga 14% sa ishte në vitin 2020. Për sistemin bankar në tërësi, raporti i aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra vazhdoi të mbetet në 34.1% në muajin shkurt dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 14.8%, që të dyja këto mbi minimumet rregullatore prej 25% dhe 12% respektivisht (Komisioni Evropian).

2.6 Zhvillimet fiskale

Në përputhje me rimëkëmbjen ekonomike, të ardhurat tatimore në vitin 2021 u rritën për 29.8% në vit. Të ardhurat nga tatimet direkte dhe indirekte u rritën për 25% dhe 31% përkatësisht, dhe tejkaluan ndarjet e buxhetit të rishikuar për vitin 2021. Shpenzimet publike patën një rritje të lehtë prej 2.5% në krahasim me vitin 2020. Ekzekutimi i buxhetit të rishikuar 2021 nuk ishte i njëjtë në kategoritë e ndryshme. Shpenzimet kapitale u rritën për 11% krahasuar me vitin 2020, por arritën vetëm 76% të ndarjes së buxhetit të rishikuar të vitit 2021. Niveli i shpenzimeve rrjedhëse ishte afërsisht i njëjtë me shpenzimet në vitin 2020 për shkak të zbatimit të paketave mbështetëse për COVID-19, ndërkohë që shkalla e ekzekutimit të tij arriti në rreth 95% të buxhetit të rishikuar 2021 (Komisioni Evropian).

2.7. Ekonomia e brendshme


Ekonomia ka kaluar nëpër një periudhë të vështirë me përhapjen e pandemisë Covid-19, rreziqeve të reja për shoqërinë dhe ekonominë që rezultuan me krizë shëndetësore, ekonomike dhe sociale. Si çdo qeveri në botë, edhe qeveria e Kosovës ndërmoi masa kufizuese në lëvizje, aktivitete udhëtimi, aktivitete publike dhe jo publike me qëllim të kontrollimit të

pandemisë. Në vitin 2020, masat kufizuese kanë ngadalësuar aktivitetin ekonomik për 1.3 për qind në TM1 dhe kanë ulur rritjen ekonomike për 9.3 për qind në TM2 dhe 7.3 për qind në TM3. TM4 pati një rekuperim të rritjes së BPV-së për 0.7 për qind. Vlerësimi preliminar i ASK-së ka treguar se ekonomia e Kosovës ka rezultuar me një rënie të rritjes ekonomike prej 3.9 për qind në vitin 2020. Aktiviteti ekonomik pritet të rimarrë veten drejt niveleve të para krizës në vitin 2021, me një rritje prej rreth 4.3 për qind. Komponentët kryesorë që ndikuan në rritjen ekonomike ishin investimet (5,7 %) dhe eksportet neto (4,7%), përderisa komponenti i konsumatorit ka mbështetur aktivitetin ekonomik (6,5%).


Sektori i hotelarisë dhe restoranteve, i transportit, magazinimit, ndërtimtarisë, sektori administrativ dhe tregtia janë arsyeja pse BPV-ja ka shënuar rënie të vlerës. Nga ana tjetër, në rritjen e aktivitetit kontribuan sektorët si

shëndetësia dhe puna sociale, furnizimi me energji dhe gaz, industria përpunuese, komunikimi, industria nxjerrëse. Sektorët e rëndësishëm si shërbimet dhe industria u përballën me rënie të aktivitetit dhe shkallës së punësimit. Sipas ASK-së, dinamika e atyre që kryesisht janë prekur

Graph 2. Real GDP growth rate and growing contributors



Graph 3. Sales and employee indices in the service sector (2015 = 100)



nga kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia Covid-19. Mesatarja e indeksit të shitjeve neto në sektorin e shërbimeve komunale rezulton të ketë shënuar rënie prej 36.2 për qind në vitin 2020 (ritje mesatare prej 23.1 për qind në vitin 2019), dhe indeksi mesatar i numrit të të punësuarve ka shënuar rënie prej 6.4 për qind (ritje prej 13.2 për qind në vitin 2019).

2.8. Çmimet

Rënia e përgjithshme të kërkesës së bashku me dinamikën e çmimeve të mira kryesore ishin treguesit kryesorë të presioneve të dobëta inflacionare në Kosovë. Ndryshimi i përgjithshëm i çmimeve u vu re krahas indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) i cili u rrit ngadalë për 0.2 për qind në vitin 2020. Rritja e çmimeve është ndikuar më së shumti nga çmimet e transportit (-5.8%), çmimet e veshjeve (-0.9%), rekreacioni dhe kultura (-0.6%), energjia elektrike dhe gazi (-0.1%). Çmimet e ushqimeve dhe pijeve joalkoolike shënuan një rritje prej 1.7 për qind (2020), të cilat treguan rritje më të ulët krahasuar me 5.4 për qind (2019). Si rezultat i peshës së pagës së konsumatorit, çmimet e ushqimeve në Kosovë kontribuan në rritjen e ngadaltë të çmimeve.

Si rezultat i rrethanave pandemike, në vitin e fundit janë rritur çmimet e shërbimeve shëndetësore (4.7 %), pasuar nga çmimet e restoranteve dhe hoteleve (2.2 %) dhe mjeteve të komunikimit (1.9 %). Lëvizja e çmimeve në Kosovë kryesisht përcaktohet nga lëvizja e çmimeve në tregun ndërkombëtar, për shkak të mungesës së importeve. Indeksi i çmimeve të importit shënoi një ulje mesatare prej 1.9 për qind në vitin 2020.


Çmimet e produkteve minerale (-15.9%) dhe produkteve të tekstilit (-13.8%) shënuan uljen më të madhe, ndërsa çmimet e produkteve bimore (13.9%) shënuan rritjen më të madhe. Rënia më e madhe e çmimeve të prodhimit është shënuar në nxjerrjen e metaleve (-11.4%), prodhimin e makinerive dhe pajisjeve (-4.5%), prodhimin e metaleve (-3.4%) dhe prodhimin mobil (-3.3%).

Në fakt, rritje të çmimeve u shënuan në prodhimin e mjeteve motorike (6.5 %), prodhimin e qumështit dhe produkteve nga ai (6.4 %), etj.

Graph 4: Headline inflation and core inflation, annual change, in percentage

Sipas BQK-së:

Trysnitë inflacionare që shoqëruan ekonominë globale, si dhe eurozonën dhe vendet e rajonit gjatë vitit 2021, u reflektuan edhe në ekonominë e



vendit. Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rimëkëmbjes ekonomike, e shoqëruar me presionet e jashtme inflacionare si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë dhe çmimeve të mallrave të importuara nga vendet partnere, bëri që Kosova të raportojë një rritje të përgjithshme të çmimeve në vend, e matur përmes katër indekseve të përpiluara nga ASK. Indeksi i çmimeve të konsumit u rrit për 3.4% në vitin 2021, i pasuar nga indeksi i çmimeve të prodhimit i cili u rrit për 4.9%, indeksi i kostonë së ndërtimit për 10.9% dhe indeksi i çmimeve të importit i cili u rrit për 11.1%. Rritja më e lartë e çmimeve të konsumit u shënuar në TM4 të vitit 2021, kur u shënuar shkalla mesatare e inflacionit prej 6.4%. Rritja më e lartë e çmimeve gjatë këtij tremujori është shënuar në transport, mjete të komunikimit, ushqime dhe pije joalkoolike, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse. Trendi i përshpejtuar i rritjes së çmimeve pritet të vazhdojë edhe në vitin 2022 dhe sipas parashikimeve të BQK-së, norma mesatare e inflacionit për këtë vit pritet të jetë 6.4%. Ngjashëm me parashikimet e BQK-së janë edhe pritjet e bankave komerciale, të cilat deklaruan se niveli i inflacionit këtë vit do të jetë më i lartë krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit, pas pushtimit rus të Ukrainës, norma e inflacionit mund të jetë edhe më e lartë (BQK, Raporti tremujor).

3.0 Zhvillimet kryesore makroekonomike në rajon

3.1 Shqipëria

3.1.1 Zhvillimet kryesore

Me 31 janar, qeveria i paraqiti Komisionit Evropian Programin e saj të Reformës Ekonomike për periudhën 2022-2024. Ai parashikon që rritja ekonomike në periudhën 2022-2024 të jetë mesatarisht rreth 4%. Skenari makroekonomik nuk ka mundur të merrte parasysh ende ndikimin e pushtimit rus të Ukrainës, veçanërisht ndikimin në dinamikën e eksporteve dhe në inflacion. Programi synon konsolidimin fiskal me ritme të moderuara, të bazuar kryesisht në një zvogëlim të madh të shpenzimeve kapitale në vitin 2023 dhe bilanc primar pozitiv nga viti 2024. Qeveria e Shqipërisë krijoi një “bord të transparencës”, i cili përcakton çmimet e mallrave me pakicë bazuar në marzhat fikse të fitimit si një përpjekje për të frenuar spekulimet me çmimet ndërkombëtare të mallrave. Ndryshimi i parë buxhetor në vitin 2022 përfshinte një provizion prej rreth 230 milionë eurosh (të quajtur “Paketa e Rezistencës Sociale” prej 26 miliardë lekësh, 1.8% e BPV-së) për të ruajtur stabilitetin e çmimeve të energjisë elektrike të administruar për familjet dhe NVM-të, pasi po rriteshin çmimet për energjinë elektrike të importuar dhe për të ofruar mbështetje shtesë për familjet dhe bujqit në nevojë për përballimin e rritjes së çmimeve të karburanteve dhe ushqimeve.

3.1.2 Zhvillimet monetare

Inflacioni vazhdoi të rritet, nga mesatarja 3.1% në TM4 të vitit 2021 në 4.4% në TM1 të vitit 2022, 5.7% të shkaktuar nga kërkesa e madhe dhe rritja e çmimeve të ushqimeve, e rënduar nga ndikimi që kishte pushtimi i Ukrainës në çmimet e drithërave, vajrave ushqimorë dhe karburantit në muajin mars, kur shkalla e inflacionit u rrit në 5.7%. Banka e Shqipërisë (BSH) pret që këto presione inflacionare të vazhdojnë dhe ka filluar të stabilizojë gradualisht qëndrimin e saj të politikës së jashtëzakonshme akomoduese, e cila kishte mbetur e pandryshuar që nga marsi 2020. Më 23 mars 2022, ajo rriti normën bazë për 0.5 pikë të përqindjes në 1.0% dhe normën e kredisë njënatëshe për 1 pikë përqindje në 1.9%, ndërkohë që e ka mbajtur të pandryshuar normën e depozitave njënatëshe në nivelin aktual prej 0.1%.

3.1.3 Sektori financiar

Kreditimi për sektorin privat u rrit në mënyrë krahasuese për 11.8% në muajin shkurt, mbështetur nga primet e ulëta të rrezikut, të cilat mundësuan lehtësimin e standardeve të

kreditimit. Rritja e kredisë për bizneset u përshpejtua në 9.1% në vit në TM4, por për dallim nga tremujorët e mëparshëm, ajo u ndikua më shumë nga nevojat për likuiditet sesa nga qëllimet e investimit. Kreditimi për ekonomitë familjare po ashtu vazhdoj të rritet, me 11.6% (0.7 pikë të përqindjes më e lartë se në TM3), e nxitur kryesisht nga kreditë hipotekare, për të cilat ishin lehtësuar kushtet. Trendi në ngritje i rritjes së kreditimit është mbështetur kryesisht nga kreditimi në lek, megjithëse rritja vjetore e saj u ngadalësua pak krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2021, në 9.7% në TM4.

3.2 Mali i Zi

3.2.1 Zhvillimet kryesore

Më 31 janar 2021, qeveria i paraqiti Komisionit Evropian Programin e saj të Reformës Ekonomike (PRE) 2022-2024. Ky program, i përgatitur para pushtimit të Ukrainës nga Rusia, parashikonte që BPV-ja reale të rikthehet në nivelin e saj të para krizës COVID-19 në vitin 2022 dhe më pas të mbajë një rritje të fuqishme. Ekonomia pritet të përfitojë nga një stimulim i fortë fiskal në vitin 2022, i cili do të rris deficitin në 5% të BPV-së në vitin 2022, i pasuar nga një konsolidim gradual fiskal në dy vitet e ardhshme bazuar në shkurtimin e shpenzimeve. Më 4 shkurt 2022, ra qeveria e koalicionit e kryeministrit Zdravko Krivokapiq pas një votimi të mosbesimit në Parlament 14 muaj pas formimit të qeverisë. Më 20 prill, i emëruari për kryeministër Abazović thirri parlamentin që të mbaj një seancë për të votuar qeverinë e re, duke u mbështetur në përkrahjen e 46 nga 81 deputetët. Më 4 mars, Standard&Poor's konfirmojë vlerësimin e kredisë sovrane të Malit të Zi 'B/B' afatgjatë dhe afatshkurtër në valutë vendore dhe të huaj. Perspektiva stabile pasqyron pikëpamjen e agjencisë se rritja ekonomike do të mbetet solide dhe do të mbështesë një konsolidim gradual të financave publike. Megjithatë, rënia e kohëve të fundit e qeverisë së koalicionit ngjall pasiguri në lidhje me reformat ekonomike dhe buxhetore. Më 7 mars, tranzicioni digjital i Malit të Zi vazhdoi me shtrirjen e parë komerciale të shërbimeve të telekomit 5G. Shtrirja e rrjetit 5G ka nisur në kryeqytetin Podgoricë dhe planifikohet të shtrihet edhe në zonat bregdetare gjatë verës.

3.2.2 Zhvillimet monetare

Pas rënies për 0.8% në vitin 2020, çmimet e konsumit u rritën me shpejtësi nga prilli 2021, për të arritur një mesatare prej 2.5% në vitin 2021. Presionet inflacionare vazhduan edhe në vitin 2022. Çmimet e konsumit u rritën për 6.4% në muajin shkurt, pas rritjes për 5.4% në vit në janar. Ushqimi dhe transporti (duke përfshirë në këtë të fundit edhe lëndët djegëse)

mbeten faktorët kryesorë të inflacionit, duke u rritur për 13.1% dhe 12.7% përkatësisht, në muajin shkurt. Gjithashtu, çmimet më të larta i shënuan edhe hotelet dhe restorantet, me 4.5% në vit në muajin shkurt.

3.2.3 Sektori financiar

Sektori bankar i Malit të Zi vazhdoi të zgjerohet në fillim të vitit 2022. Kreditimi bankar në muajin shkurt 2022 u rrit për 6.9% krahasuar me vitin paraprak pas rritjes për 5.8% në janar krahasuar me vitin paraprak. Rritja u ndikua nga kreditë për sektorin privat, të cilat u rritën për 8.8% krahasuar me vitin paraprak, ndërsa kreditë për qeverinë e përgjithshme në muajin shkurt u tkurrën për 12.5% krahasuar me vitin paraprak.

3.3 Serbia

3.3.1 Zhvillimet kryesore

Më 31 janar, Serbia e paraqiti programin e saj të reformës ekonomike (PRE) 2022-2024. PRE, i përgatitur para pushtimit të Ukrainës nga Rusia, parashikonte që rritja e BPV-së në vitin 2022 të arrijë në 4.5% dhe më pastaj të jetë 5% dhe deficitin e qeverisë së përgjithshme të bjerë gradualisht nga 3% e BPV-së në vitin 2022 në 1% të BPV-së në vitin 2024. Sipas rezultateve të përkohshme të zgjedhjeve serbe të 3 prillit 2022, presidenti aktual dhe lideri i Partisë Progresive Serbe (SNS) Aleksandar Vuçiç u rizgjodh në raundin e parë me 58.6% të votave. Në zgjedhjet e përgjithshme, 7 parti kaluan kuorumin prej 3% për të hyrë në kuvendin popullor: SNS në pushtet (43.0%), Serbia e Bashkuar (13.6%), Partia Socialiste e Serbisë (11.5%), Nada/Shpresa (5.4%), Moramo/Duhet (4.6%), Dveri (3.8%) dhe Zavetnici (3.7%). Më 7 prill 2020, Banka Kombëtare e Serbisë e rriti normën e saj bazë për 50 pikë të përqindjes në 1.5%, duke marrë parasysh se presionet inflacionare më këmbëngulëse se sa që pritej kërkonin shtrëngime monetare shtesë për të mbajtur nën kontroll efektet e raundit të dytë në pritjet inflacionare. Norma kishte mbetur në një nivel të ulët rekord prej 1.0% për 16 muaj.

3.3.2 Zhvillimet monetare

Inflacioni vjetor i çmimeve të konsumit vazhdoi të rritej për rreth 0.4 pikë përqindjeje në muaj nga nëntori 2021 deri në mars 2022, duke arritur në 9.1% në mars, duke tejkaluar kështu në masë të madhe kufirin e sipërm të objektivit të tolerancës së bankës qendrore prej

3% /-1.5 pikë të përqindjes për shtatë muaj radhazi. Inflacioni vazhdoi të nxitet nga çmimet e ushqimeve (16.1%) dhe çmimet e karburanteve (18.3%).

3.3.3 Sektori financiar


Në muajin shkurt, kërkesat e brendshme të sektorit bankar u rritën për 8.5% krahasuar me një vit më herët. Pas një ngritjeje nga 10.1% në nëntor 2021 në 10.6% në dhjetor, rritja vjetore e kreditimit për individët u stabilizua në masë të madhe në 10.5% në janar dhe 10.4% në shkurt. Në mënyrë të ngjashme, pas një rritjeje nga 5.8% në nëntor 2021 në 7.1% në dhjetor, rritja e kreditimit për kompanitë u ul në 6.7% në janar para se të rritej në 7.0% në shkurt.

4.0 Përmbledhje


Ekonomia ka kaluar nëpër një periudhë të vështirë me përhapjen e pandemisë Covid-19, rreziqet e reja për shoqërinë dhe ekonominë që rezultuan me krizë shëndetësore, ekonomike dhe sociale. PRE parasheh një kthim gradual në tavanin e deficitit fiskal të BPV-së prej 2%, siç parashikohet me kornizën e rregullave fiskale të Kosovës, deri në vitin 2023. Me ndihmën e diasporës, ekonomia e Kosovës pati një shkallë të lartë të rimëkëmbjes, vlerësimi provizor i rritjes vjetore të BPV-së në vitin 2021 ishte 10.5% (grafiku 5). Sa i përket tregut të punës, Kosova vazhdon të ketë shkallën më të lartë të papunësisë në rajon, të dhënat më të fundit në dispozicion, paraqesin një shkallë të papunësisë prej 25.8% (TM1 2021). Nga viti 2020 në 2021 deficitin është rritur për 2.2% (2020 - 7% , 2021 - 9.2%). Shtytësi kryesor i kësaj ishte rritja e madhe e importeve të mallrave (41%), e cila baraspeshoi performancën e mirë të eksportit dhe bëri që deficitin tregtar të mallrave të rritej në 53% të BPV-së. Faktori kryesor që kompenson deficitin tregtar të mallrave janë remitencat, të cilat u rritën për 20% në vitin 2021 dhe arritën në 15.8% të BPV-së. Rritja e kreditimit bankar u rrit në 11.2% në vitin 2021 nga 7.1% sa ishte një vit më herët. Rritja e depozitave shkoi në 13.8% nga 12.2% në vitin 2020. Treguesit e shëndetit financiar kanë mbetur të kënaqshëm. Në fund të vitit 2021, raporti kredi/depozita dhe raporti i kredive joperformuese (NPL) mbetën në 76.5% dhe 2.1% përkatësisht. Në përputhje me rimëkëmbjen ekonomike, të ardhurat tatimore në vitin 2021 u rritën për 29.8% krahasuar me një vit më herët. Të ardhurat nga tatimet direkte dhe indirekte u rritën për 25% dhe 31% përkatësisht dhe tejkaluan ndarjet e buxhetit të rishikuar për vitin 2021. Shpenzimet publike patën një rritje të lehtë prej 2.5% në krahasim me vitin 2020. Rënia e përgjithshme e kërkesës që ndodhi paralelisht me dinamikën e çmimeve të mallrave kryesore ishin treguesit kryesorë të presioneve të dobëta inflacionare në Kosovë. Ndryshimi i përgjithshëm i çmimeve u vërejt në indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK) që u rrit ngadalë për 0.2 për qind në vitin 2020. Rritja

e çmimeve është ndikuar më së shumti nga çmimet e transportit (-5.8%), çmimet e veshjeve (-0.9%), rekreacioni dhe kultura (-0.6%), energjia elektrike dhe gazi (-0.1%). Presionet inflacionare që shoqëruan ekonominë globale, si dhe eurozonën dhe vendet e rajonit gjatë vitit 2021, u reflektuan edhe në ekonominë e vendit (grafiku 6). Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rimëkëmbjes ekonomike, e shoqëruar me presionet e jashtme inflacionare si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë dhe çmimeve të mallrave të importuara nga vendet partnere, bëri që Kosova të raportojë një rritje të përgjithshme të çmimeve në vend, e matur përmes katër indekseve të përpiluar nga ASK.

Grafiku 5. Grafikët krahasues, Kosova dhe Rajoni, (Burimi: trading economics)



Grafiku 6. Inflacioni i Kosovës dhe rajon (Maj 2021 – Prill 2021) (Burimi: trading economics)



Referencat

Agjencia e Statistikave të Kosovës. *Tregtia e Jashtme e Mallrave*. Shkurt, 2021 [AFP2007 \(rks-gov.net\)](https://rks.gov.net)

Agjencia e Statistikave të Kosovës. *Tregtia e Jashtme e Mallrave*. Shkurt, 2022 [AFP2007 \(rks-gov.net\)](https://rks.gov.net)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, *Raporti Vjetor 2020* Prishtinë , 2021

News BBC. 2022. *Energy prices: Why are power bills going up?* [Çmimet e energjisë: Pse po rritet çmimi i faturave të energjisë elektrike?] [online] Në dispozicion në: <<https://www.bbc.co.uk/news/uk-northern-ireland-58558645>> [Shikuar më 18 maj 2022].

Európai Bizottság - Komisioni Evropian. 2022. *Quarterly Report on the Euro Area (QREA), Vol. 21, No. 1 (2022)* [Raporti tremujor për Eurozonën (QREA), vol. 21, no. 1 (2022)] [online] Në dispozicion në: <https://ec.europa.eu/info/publications/quarterly-report-euro-area-qrea-vol-21-no-1-2022_hu> [shikuar më 19 maj 2022].

Komisioni Evropian *EU Candidate Countries & Potential Candidates' Economic Quarterly (CCEQ)* [Tremujori Ekonomik i Vendeve Kandidate dhe Kandidate Potencialë për Anëtarësim në BE (CCEQ)], Tremujori i parë 2022, Dokument Teknik 056, Prill, 2022

Tradingeconomics.com. 2022. *TRADING ECONOMICS | 20 million INDICATORS FROM 196 COUNTRIES [EKONOMIA TREGTARE | 20 milionë TREGUES NGA 196 VENDE]* [online] Në dispozicion në: <<https://tradingeconomics.com/>> [shikuar më 19 maj 2022].

World Bank. 2022. “Commodity Markets Outlook”. The impact of the war in Ukraine on commodity markets, [“Perspektiva e tregjeve të mallrave”. Ndikimi i luftës në Ukrainë në tregjet e mallrave], fq. 9 -10. 2022. *Perspektiva e Tregjeve të Mallrave*. [online] Në dispozicion në: <<https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2022/04/26/food-and-energy-price-shocks-from-ukraine-war>> [shikuar më 18 maj 2022].

Tabela 1: Vendet kandidate dhe kandidate potenciale

European Commission, ECFIN-D-1

Candidate and potential candidate countries: Summary table

| | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | ECFIN 2021 Autumn forecast | | Q3 21 | Q4 21 | Q1 22 | Jan 22 | Feb 22 | Mar 22 |
|--|-------|-------|-------|-------|------|-------------------------------|-------|-------|-------|-------|--------|--------|--------|
| | | | | | | 2022 | 2023 | | | | | | |
| Gross domestic product (in real terms, annual % change) | | | | | | | | | | | | | |
| Albania | 3.8 | 4.0 | 2.1 | -3.5 | 8.3 | 3.7 | 3.6 | 6.8 | 5.5 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| North Macedonia | 1.2 | 2.8 | 3.9 | -6.1 | 4.2 | 3.9 | 3.7 | 3.0 | 2.3 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Montenegro | 4.7 | 5.1 | 4.1 | -15.3 | 12.4 | 6.4 | 3.2 | 25.8 | 8.2 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Serbia | 2.1 | 4.5 | 4.3 | -0.9 | 7.4 | 4.3 | 4.3 | 7.6 | 7.0 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Turkey | 7.5 | 3.0 | 0.9 | 1.8 | 11.0 | 4.0 | 4.0 | 7.5 | 9.1 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Bosnia and Herzegovina | 3.0 | 3.3 | 2.8 | -3.2 | 7.1 | : | : | 6.9 | 7.6 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Kosovo | 4.8 | 3.4 | 4.8 | -5.3 | 10.5 | : | : | 14.5 | 6.4 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Unemployment | | | | | | | | | | | | | |
| Albania | 14.1 | 12.8 | 12.0 | 12.2 | 12.1 | 11.0 | 10.3 | 11.6 | 11.9 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| North Macedonia | 22.6 | 21.0 | 17.5 | 16.6 | 15.8 | 15.1 | 14.6 | 15.9 | 15.3 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Montenegro | 16.4 | 15.5 | 15.4 | 18.4 | 16.9 | 18.5 | 17.2 | 15.0 | 15.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Serbia | 14.5 | 13.7 | 11.2 | 9.7 | 11.0 | 10.0 | 9.2 | 10.5 | 9.8 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Turkey | 10.9 | 10.9 | 13.7 | 13.1 | 12.0 | 12.6 | 12.2 | 11.7 | 11.0 | : | 12.1 | 11.4 | : |
| Bosnia and Herzegovina | 20.5 | 18.4 | 15.7 | 15.9 | 17.4 | : | : | 16.4 | 16.1 | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| Kosovo | 30.5 | 29.6 | 25.7 | 25.9 | : | : | : | : | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Current account balance* (% of GDP) | | | | | | | | | | | | | |
| Albania | -7.5 | -6.8 | -7.9 | -8.7 | -7.9 | -7.3 | -7.1 | -6.6 | -7.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| North Macedonia | -1.0 | -0.1 | -3.3 | -3.4 | -3.5 | -2.6 | -2.2 | -1.2 | -3.5 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Montenegro | -16.1 | -17.0 | -14.3 | -26.1 | -9.2 | -15.8 | -16.8 | -10.1 | -9.2 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Serbia | -5.2 | -4.8 | -6.9 | -4.1 | -4.4 | -4.3 | -4.1 | -3.0 | -4.4 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Turkey | -4.8 | -2.8 | 0.7 | -5.0 | -1.7 | -2.2 | -1.6 | -2.3 | -1.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Bosnia and Herzegovina | -4.8 | -3.3 | -2.8 | -3.8 | -2.1 | -12.9 | -5.9 | -2.3 | -2.1 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Kosovo | -5.5 | -7.6 | -5.7 | -7.0 | -9.2 | : | : | -6.0 | -8.6 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Inflation (Consumer price index, annual % change) | | | | | | | | | | | | | |
| Albania | 2.0 | 2.0 | 1.4 | 1.6 | 2.0 | 2.8 | 2.7 | 2.4 | 3.1 | 4.4 | 3.7 | 3.9 | 5.7 |
| North Macedonia | 1.4 | 1.5 | 0.8 | 1.2 | 3.2 | 2.1 | 1.8 | 3.6 | 4.6 | : | 6.7 | 7.6 | 8.8 |
| Montenegro (HICP) | 2.8 | 2.9 | 0.5 | -0.8 | 2.5 | 2.5 | 1.5 | 3.7 | 4.3 | : | 5.4 | 6.4 | : |
| Serbia | 3.1 | 2.0 | 1.8 | 1.6 | 4.1 | 3.6 | 2.6 | 4.4 | 7.3 | : | 8.3 | 8.8 | : |
| Turkey | 11.1 | 16.3 | 15.2 | 12.3 | 19.6 | 17.7 | 15.4 | 19.3 | 25.8 | 54.8 | 48.7 | 54.4 | 61.1 |
| Bosnia and Herzegovina | 1.3 | 1.4 | 0.6 | -1.1 | 2.0 | : | : | 2.4 | 5.3 | : | 7.0 | 8.1 | : |
| Kosovo | 1.5 | 1.1 | 2.7 | 0.2 | 3.3 | : | : | 4.3 | 6.4 | : | 7.1 | 7.5 | : |
| General government balance** (% of GDP) | | | | | | | | | | | | | |
| Albania | -2.0 | -1.6 | -1.9 | -6.7 | -4.5 | -4.0 | -3.5 | -0.4 | -2.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| North Macedonia | -2.7 | -1.8 | -2.0 | -8.2 | -5.4 | -4.9 | -4.3 | -1.2 | -2.0 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Montenegro | -5.3 | -3.9 | -2.0 | -11.1 | -1.9 | -0.5 | 0.2 | 2.3 | -0.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Serbia | 1.1 | 0.6 | -0.2 | -8.0 | -4.1 | -2.7 | -1.6 | -0.5 | -3.1 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Turkey | -2.0 | -2.8 | -3.2 | -2.9 | : | -3.5 | -3.1 | -0.6 | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Bosnia and Herzegovina | 2.6 | 2.2 | 1.9 | -5.3 | : | : | : | 1.2 | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Kosovo | -1.3 | -2.9 | -2.9 | -7.6 | -1.4 | : | : | 2.0 | -2.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |

Forecast: ECFIN forecast Autumn 2021 published November 2021.

* Q figures refer to a 4 quarters moving average.

** Q figures refer to the quarterly balance divided by the estimated annual GDP.

Tabela 2: Kosova

TABLE

European Commission, ECFIN-D-1



KOSOVO

| | | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | Q3 21 | Q4 21 | Q1 22 | Jan 22 | Feb 22 | Mar 22 |
|---|-----------|-------|-------|-------|-------|---------|---------|---------|-------|---------|---------|--------|
| 1 Real sector | | | | | | | | | | | | |
| Industrial confidence ^{1.1} | Balance | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| Industrial production ^{1.2} | Ann. % ch | -1.3 | -0.7 | 2.6 | -1.2 | : | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| Gross domestic product ^{1.3} | Ann. % ch | 4.8 | 3.4 | 4.8 | -5.3 | 10.5 | 14.5 | 6.4 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Private consumption ^{1.4} | Ann. % ch | 2.5 | 3.8 | 5.1 | 1.9 | 7.6 | 1.4 | 9.4 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Investment ^{1.5} | Ann. % ch | 0.6 | 7.0 | -1.6 | -7.1 | 10.2 | 0.1 | 0.8 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Construction index ^{1.6} | Ann. % ch | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| Retail sales ^{1.7} | Ann. % ch | 12.0 | 17.4 | 25.6 | -0.4 | 11.0 | 24.4 | 8.4 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| 2 Labour market | | | | | | | | | | | | |
| Unemployment ^{2.1} | % | 30.5 | 29.6 | 25.7 | 25.9 | : | : | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Employment ^{2.2} | Ann. % ch | 7.6 | -3.4 | 5.2 | -4.4 | : | : | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Wages ^{2.3} | Ann. % ch | 2.1 | 5.1 | 5.3 | -2.3 | : | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| 3 External sector | | | | | | | | | | | | |
| Exports of goods ^{3.1} | Ann. % ch | 22.1 | -2.8 | 4.4 | 23.8 | 57.9 | 65.7 | 45.6 | : | 50.9 | 34.8 | : |
| Imports of goods ^{3.2} | Ann. % ch | 9.2 | 9.7 | 4.6 | -5.7 | 41.1 | 48.0 | 34.8 | : | 43.4 | 37.5 | : |
| Trade in goods balance ^{3.3} | % of GDP | -42.0 | -44.6 | -44.1 | -41.7 | -53.2 | -48.1 | -49.9 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Exports goods and services ^{3.4} | % of GDP | 27.3 | 29.1 | 29.3 | 21.7 | : | 33.7 | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Imports goods and services ^{3.5} | % of GDP | 53.1 | 57.3 | 56.4 | 53.9 | : | 63.8 | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Current account balance ^{3.6} | % of GDP | -5.5 | -7.6 | -5.7 | -7.0 | -9.2 | -6.0 | -8.6 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Direct investment (FDI, inflow) ^{3.7} | % of GDP | 3.3 | 3.4 | 2.7 | 4.2 | : | 5.0 | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| International reserves ^{3.8} | mn EUR | 939.4 | 933.9 | 937.1 | 969.1 | 1,060.6 | 1,192.3 | 1,060.6 | : | 1,136.4 | 1,156.8 | : |
| Int. reserves / months Imp ^{3.9} | Ratio | 3.3 | 2.9 | 2.8 | 3.2 | : | 3.0 | : | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| 4 Monetary developments | | | | | | | | | | | | |
| HICP ^{4.1} | Ann. % ch | 1.5 | 1.1 | 2.7 | 0.2 | 3.3 | 4.3 | 6.4 | : | 7.1 | 7.5 | : |
| Producer prices ^{4.2} | Ann. % ch | 0.6 | 1.4 | 0.9 | -0.6 | 4.9 | 6.9 | 7.2 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| Food prices ^{4.3} | Ann. % ch | 1.2 | 2.7 | 8.3 | 10.1 | 12.7 | 3.1 | 6.3 | : | 8.8 | 9.7 | : |
| Broad money liabilities ^{4.4} | Ann. % ch | 6.4 | 7.9 | 12.0 | 15.3 | 12.1 | 16.9 | 12.1 | : | 11.8 | 11.6 | : |
| Exchange rate EUR/EUR ^{4.5} | Value | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 | 1.0 |
| Real effective exchange rate (CPI) ^{4.6} | Index | 105.0 | 104.7 | 107.1 | 107.3 | 109.8 | 109.8 | 111.5 | : | 112.4 | 113.1 | : |
| 5 Financial indicators | | | | | | | | | | | | |
| Short-Term interest rate ^{5.1} | % p.a. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| Bond yield ^{5.2} | % p.a. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | 3.84 | N.A. |
| Stock markets ^{5.3} | Index | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. | N.A. |
| Credit growth ^{5.4} | Ann. % ch | 10.5 | 11.1 | 10.7 | 7.7 | 11.2 | 12.1 | 14.5 | : | 15.7 | 16.7 | : |
| Deposit growth ^{5.5} | Ann. % ch | 8.6 | 6.5 | 12.6 | 12.2 | 13.8 | 15.2 | 12.9 | : | 11.1 | 9.5 | : |
| Non-performing loans ^{5.6} | % total | 3.0 | 2.5 | 1.9 | 2.5 | 2.1 | 2.2 | 2.1 | : | 2.1 | : | : |
| 6 Fiscal developments | | | | | | | | | | | | |
| General government balance ^{** 6.1} | % of GDP | -1.3 | -2.9 | -2.9 | -7.6 | -1.4 | 2.0 | -2.7 | : | N.A. | N.A. | N.A. |
| General government debt ^{*** 6.2} | % of GDP | 16.4 | 17.0 | 17.6 | 22.4 | 23.3 | 23.0 | 23.3 | : | N.A. | N.A. | N.A. |

* Q figures refer to a 4 quarters moving average.

** Q figures refer to the quarterly balance divided by the estimated annual GDP.

*** Q figures in percent of estimated annual GDP from the Budget Law.






Tabela 2a: Kosova

CHARTS

European Commission, ECFIN-D-1



KOSOVO



Source of data: IMF, national sources

Tabela 3: Shqipëria

CHARTS

European Commission, ECFIN-D-1



ALBANIA









Tabela 4: Mali i Zi

CHARTS

European Commission, ECFIN-D-1



MONTENEGRO








Tabela 5: Serbia



SERBIA

